

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenin 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (tekst i pastruar) nr.ark.01-4898/1 datë 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1233/1 datë 19.3.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-1838/12 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi si vijon:

### **Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËRON Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 50, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV) dhe nenit 16 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RrMPM), në mënyrë që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 3 mars 2026, filmi artistik "G.I Jane (XHI-AJ XHEJN)", i shënuar si program i kategorisë së tretë (12+), u transmetua në periudhë kohore të papërshtatshme të ditë-natës.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1233/1 datë 19.3.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. URDHËROHET që ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV dhe RrMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit të tij në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

### **A r s y e t i m**

Agjencia, në bazë të nenit 28 të LShMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmer masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga leja dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50, paragrafi (1) të LShMAAV, transmetuesit nuk mund të transmetojnë ose të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në veçanti programe me përmbajtje pornografike ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, me kërkesë, duhet të marrin masat më të rrepta teknike për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtja më e dëmshme, siç është dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve të përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve ofrohen dhe nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele në mënyrë të tillë që të miturit të mos mund t'i shohin ose t'i dëgjojnë normalisht programet. Kur programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele është i detyruar para transmetimit të ofrojë paralajmërim paraprak akustik dhe mundësinë e njohjes me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 të LShMAAV).

Në nenin 16 të RrMPM janë përcaktuar periudhat kohore për kategoritë e programeve, sipas të cilave përcaktohet se në varësi të përbërjes së pritur të publikut, kategoritë e programeve mund të transmetohen në periudhat kohore si në vijim: Programet e kategorisë së parë dhe të dytë transmetohen gjatë gjithë ditë-natës; Kategoria e tretë transmetohet në periudhën nga ora 20:00 deri në orën 05:00; Kategoria e katërt transmetohet në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00; Kategoria e pestë transmetohet në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 5:00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 19 mars 2026, ka kryer kreu mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, të transmetuar më 3 mars 2026, në nivel shtetëror, ku u konstatua shkelje të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV dhe nenit 16 të RrMPM, në mënyrë që bie ndesh me nenin 16 (periudha kohore për kategoritë e programeve) nga RrMPM, filmi artistik "G. I. Jane "( XHI - AJ GJONI)", është shënuar në mënyrë të përshtatshme me sinjalin paralajmërues, për program të - Kategorisë së Tretë (12+) , por është transmetuar në kohë të papërshtatshme të ditë-natës. Sipas udhëzimeve të RrMPM, programet, skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhumshme psiko-fizike, të cilat mund të shqetësojnë të miturit dhe klasifikohen si - program i kategorisë së tretë (12+), i cili nuk rekomandohet për fëmijë nën 12 vjeç, për të cilët rekomandohet mbikëqyrja nga prind/kujdestar, mund të transmetohen vetëm në periudhën nga ora 20:00 deri në 05:00.

Shkelja nga pika 1 të këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1233/1 datë 19.3.2026, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup më 24.3.2026, dërgoi Shkresë nr.y në ark.10-1233/2 datë 24.3.2026, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.10-1233/1 datë 19.3.2026, me qëllim në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklarament me shkrim në lidhje me shkeljen e kryer të dispozitave të LShMAAV dhe RrMPM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 25.3.2026. Në afatin e parashikuara ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, drejtuar Agjencisë nuk dorëzoi deklarament me shkrim. Këshilli në Agjencia në seanca mbajtur më 27.4.2026, pasi shqyrtoi raportin me shkrim konkludoi që ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, t'i shqiptoi masë-paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenit 16 të RrMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1233/1 datë 19.3.2026 dhe Konkluzionin nr.ark. 02-1838/12 datë 27.4.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LShMAAV dhe RrMPM; përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LShMAAV dhe RrMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv..

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, nr.ark.10-1233/1 datë 19.3.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho Stefanovski**

**Këshillë ligjore:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani